

TAKIMI I KATËRT 2025 - KOMITETI SEKTORIAL I MIKPRITJES DHE TURIZMIT

Mbledhja e katërt e Komitetit Sektorial të Mikpritjes dhe Turizmit u mbajt më datë **16.12.2025**.

Mbledhja u zhvillua në shkollën: “Hoteleri - Turizëm”, Tiranë, meqë anëtarët kishin shprehur dëshirën për të vizituar një nga shkollat e turizmit. Drejtoresha e shkollës, prezantoi anëtarët me historikun e shkollës, kapacitetet, zhvillimet dhe gjithë veprimtarinë e saj në kuadër të përgatitjes së një fuqie punëtore cilësore dhe të kualifikuar sipas kërkesave të tregut. Drejtoresha shpjegoi se, shkolla “Hoteleri - Turizëm”, Tiranë ofronte një paketë ndërkombëtare. Ajo informoi se, gjatë vitit 2025 shkolla ofronte tre kualifikimet, që ishin në bashkëpunim me “Ecole Hôtelière de Lausanne (EHL)”, si dhe kualifikime të tjera: **“Kuzhinë - Pasticëri (dual)”**, **“Shërbim në hotel dhe restorant”**, **“Guidë turistike”** dhe **“Reception”**. Drejtoresha shpjegoi gjithashtu se, vitin e ardhshëm shkolla synonte të hapte kualifikimin pas të mesëm: **“Menaxhim i strukturave akomoduëse”**. Drejtoresha informoi se, për momentin shkolla kishte 800 nxënës, një numër që tregonte një tendencë rritjeje dhe se, **“Kuzhina”** ishte kualifikimi me kërkesën më të madhe.

Në përfundim të prezantimit, të gjithë pjesëmarrësit vizituan ambientet e shkollës. Gjatë kësaj vizite pjesëmarrësit u njohën me klasat dhe mjediset e punës ku zhvilloheshin praktikat mësimore të **“Kuzhinë”**, **“Bar - Restorant”** dhe **“Teknologji ushqimore”**. Gjithashtu, pjesëmarrësit patën mundësi të shikonin nxënësit në simulime të vogla të situatave të ndryshme të punës.

Pas përfundimit të vizitës në shkollë, anëtarët diskutuan mbi ofertën ekzistuese dhe mënyrat e përmirësimit të saj. Sekretariati Teknik evidentoi se, meqë e gjithë oferta ekzistuese në fushën e “Hoteleri - Turizëm” ishte validuar nga Komiteti Sektorial, vizita mund të shërbente si një moment reflektimi për të parë se si mund të avanconte ose të përmirësohej kjo ofertë.

Drejtoresha e shkollës shpjegoi se, vitin e kaluar, shkolla kishte hasur problematika me realizimin e kualifikimit profesional: **“Reception (dual)”**, pasi bizneset kishin refuzuar të merrnin nxënësit me pagesë dhe sigurime, siç parashikonte legjislacioni - një situatë që nuk kishte ndodhur asnjëherë më parë gjatë realizimit të praktikave të shkollës në biznes. Fakti që **“Reception”** filloi sistemin dual dhe dështoi tregoi se, biznesi nuk e kishte përballuar mundësinë që nxënësit të vazhdonin vitin e dytë dhe kjo ishte një hap mbrapa për sistemin dual. Anëtarët propozuan që Komiteti Sektorial mund të bashkëpunonte me shkollën për të gjetur biznese të mëdha, që ishin të suksesshme dhe që kishin krijuar një emër serioz, që mund të bashkëpunonin për ofrimin e sistemit dual.

Gjithashtu, nga diskutimet e anëtarëve doli e nevojshme ofrimi i një kualifikimi pas të mesëm për menaxhimin e një operatori turistik ose agjencie turistike, si një kualifikim me kërkesë të lartë nga bizneset dhe mungesë të ndjeshme të fuqisë punëtore.

Vendime të marra nga mbledhja:

- U propozua ofrimi i një kualifikimi pas të mesëm për menaxhimin e një operatori turistik ose agjencie turistike.